



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal off Kaçanik

01Nr. 08-104-1741/17
Kaçanik, 27.01.2017

Në bazë të nenit 17 (c) të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisjen Lokale, të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës Nr. 03/L-00, të nenit 6.2 dhe 61.1 të Statutit të Komunës të Komunës, të Vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr. 400-32017/16 të Buxhetit të Komunës për vitin 2017, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 27 Janar 2017, mori këtë:

V E N D I M

PËR DESTINIMIN E MJETEVE FINANCIARE PËR REALIZIMIN E PROJEKTEVE TË DREJTORISË SË BZHRP TË PARAPARA ME BUXHETIN E VITIT 2017

1. Me këtë Vendim, buxheti i lejuar për vitin 2017 nga mjetet e Subvencioneve dhe Transfereve në shumë **60.000.00 €** (Gjashtëdhjetëmijë euro) me destinim për realizimin e projekteve të drejtorisë së Bujqësisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë, shpëndahe për këto projekte:

1.1. Projekti për mbështetje të fermerëve me pajisje për sistemin pikë-pikë, për sipërfaqet e mbjella me mjedër, në shumë: **13.000.00 €**;

1.2. Projekti për mbështetje të fermerëve makina mjelëse, në shumë **12.000.00 €**;

1.3. Projekti për subvencionimin e fermerëve me farë gruri dhe pleh mineral, shuma e mjeteve: **25.000.00 €**.

1.4. Projekte tjera me bashkëfinancim me donatorë dhe fermerë, në shumë **10.000.00 €**;

2. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen : drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë dhe drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit.

3. Obligohet drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë t'i merr veprimet e nevojshme për implementimin e projekteve, sipas projekteve të detajuara të cilat gjenden në këtë drejtori.

4. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrrën e Protokolit të autoritetit mbikqyrës-MAPL si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë;
3. Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit; dhe
4. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi